Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 299/19
Datë/Datum 17.07.19
PRISHTINE - PRIŠTINA

PSH.nr. 299/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Nuhi Paçarizi– Kryetar, z. Blerim Dina- Referues, z.Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Er-Lis" SH.P.K. & N.N.T."EingCom"- Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE N.P.G."Malsia"–Istog, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal", me numër të prokurimit: 644-18-8683-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Vushtrri,më datën 04.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik"Er-Lis"SH.P.K. & N.N.T."EingCom"- Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimitme titull:"Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal", me numër të prokurimit: 644-18-8683-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Vushtrri.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimitme titull"Hartimi i projekteve për nevojat e Drejtorive në Komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit: 644-18-8683-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Vushtrri dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Er-Lis" SH.P.K. & N.N.T."EingCom"-Pejë,aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë dt: 06.11.2018
Hapja e ofertave është bërë me dt:30.11.2018
Kërkesë për qasje ne dokumente zyrtare dt: 08.01.2019
Kërkesë për rishqyrtim dt: 08.01.2019
Njoftimi me letër standarde dt: 31.12.2018
Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim dt: 10.01.2019
Vendimi i OSHP-së nr.: 32/18 i dt: 20.02.2019
Njoftimi me letër standarde për tenderues e eliminuar dt: 07.03.2019
Kërkesë për rishqyrtim dt: 11.03.2019
Vendimi i AK ne kërkesën për Rivlerësim dt: 15.03.2019
Parashtrimi i Ankesa ne OSHP dt: 02.05.2019
Njoftimi me letër standarde për tenderues e eliminuar dt: 23.05.2019
Vendimi i AK për dhënie te Kontratës dt:23.05.2019
Kërkesa për rishqyrtim me dt: 27.05.2019
Autoriteti Kontraktues me datën 29.05.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "Er-Lis"SH.P.K. & N.N.T."EingCom"- Pejë,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me10.06.2019me nr. 299/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE N.P.G."Malsia"– Istog,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal", me numër të prokurimit: 644-18-8683-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Vushtrri,duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin7, 67, dhe 105 paragrafin 2.10, 2.12, dhe 2.16të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. si dhe
- Nenin 24 paragrafi 10 dhe nenin 26.8 te RrUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.06.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtuesprofesional tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:21.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:
OE ankues "Er-Lis" SH.P.K. & N.N.T."EingCom"- Pejë -pretendon se Kuvendi Komunal i Vushtrri nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së,ky nen është shkelur pasi qe AK-ja nuk i ka vlerësuar të gjithë OE njësoj,sipas OE ankues.
Qëllimi i nenit 7 të LPP-së është që AK. ti trajtojë Operatoret ekonomik në mënyrë të barabartë,pa diskriminim dhe në mënyrë transparente.
AK-së gjatë Ri-vlerësimit Operatorin Ekonomik ankues, e ka trajtuar si OE. të pasuksesshëm ngase nuk ishte tenderi me çmim më të lirë ,duke sqaruar se ishte ofertë që i plotëson të gjitha kriteret e parapara me NJ.K. dhe dosjen e tenderit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se AK-së e ka trajtuar OE Malësia si OE i përgjegjshëm dhe e ka rekomandua për shpërblim me kontratë dhe se njëjti nuk është i përgjegjshëm sipas OE ankues, ky pretendim është i bazuar dhe arsyet e pranimit të këtij pretendimi i gjeni te përgjigjja nr. 2
Andaj,Ekspertja konstaton se pretendimi i OE ankues qëndron dhe i njëjti është i pjesërisht ibazuar .

OE ankues"Er-Lis"SH.P.K. & N.N.T."EingCom"- Pejë, pretendon se Kuvendi Komunal i Vushtrrinuk ka respektuar nenin 24.10 dhe neni 26.8 te Rregullat e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, sipas OE ankues.

Qëllimi i nenit 24.10 është të rregullohet mënyra e Listës së çmimeve që gjenerohet në sistem dhe rregullat se si duhet të plotësohet dhe neni 26.8 ka për qellim të sqaroj lidhur me kriteret e përzgjedhjes që mund të përdorën nga AK-së e te cilat janë të vendosura në NJ.K. dhe në D.T.

Sipas Nenit 24 paragrafi 10 te AK ka ngarkuar : Lista e çmimeve e standardizuar është një Liste e

çmimeve që gjenerohet nga sistemi dhe përmban elemente të paracaktuara të Listës se çmimeve. Kjo Liste e çmimeve shkarkohet nga faqja e internetit të Prokurimit Publik Elektronik në Kosovë. Lista e çmimeve e standardizuar gjenerohet në formë të standardizuar të Excel-it ose kjo liste mund te plotësohet direkt në formën e sistemit ose, ne rast se kjo e liste e standardizuar nuk i plotëson nevojat (specifikat e ndryshme) e AK, AK mund të krijoj një liste te re. Pas plotësimit dhe ngarkimit, Lista e çmimeve e standardizuar shndërrohet në njëformat të Listës se çmimeve e cila është e përshtatshme për tenderuesit, me fusha të **mbyllura** të përcaktuara nga autoriteti kontraktues dhe me fushat e shënuara për tu plotësuar nga ofertuesit:

1.Çmimpër njësi 2.Norma e TVSH-së 3.Emri iprodhuesit 4.Shënimi i Ofertuesit, sipas OE ankues

Ekspertja shqyrtuese konstaton, se Dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +, - 2% duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ,

Ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetëm 4 pozicione si me ekspertizën paraprake dhe është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar andaj edhe konstaton se AK. me rastin e Ri-vlerësimit gabimisht i ka ndryshuar çmimet për njësi prapë po i përmendi vetëm 4 pozicionet e para ku OE .ka ofertuar me këto çmime për njësi si në tabelë :

Operatori Ekonomik :Malsia NPTGN.									
Nr.	**Përshkrimi I pozicioneve**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi për njësi € (pa tvsh)**	**TVSH (%)**	**Çmimi njësi me TVSH €**	**Çmimi total me TVSH € (I llogaritur nga Ekspertja e Prokurimit)**	**Çmimi total me TVSH € (I dhënë nga OE) dhe Komisioni I Rivlersimit**	**Ndryshimi I totalit të çmimit**
1	A1- Vijë e plotë e pandërprerë b=120mm	m	3800	1.79	0.32	2.11	8,026.36	6,840.00	1,186.36
2	A2 vijë e ndërprerë b=120mm(e mesit)	m	7200	0.90	0.16	1.06	7,646.40	6,480.00	1,166.40

3	A3 Vendkalim të këmbësoreve (me para-vijëzim)	m	580	7.89	1.42	9.31	5,399.92	4,640.00	759.92
4	A4 -Shenja tërthore në rrugë (vijë e ndalimit) me gjerësi 500mm	m	72	7.89	1.42	9.31	670.33	156.00	514.33
Totali i Përgjithshëm							21,743.01	18,116.00	3,627.01

Totali I përgjithshëm I dhëne nga OE	18,116.00
Dallimi ne kalkulim OE-Komisioni I Ri vlerësimit(vetëmpër 4 pozicione)	(3,627.01)
Norma e lejuar e gabimit aritmetik (për 4 pozicione)	2%
	362.32

Konstatim: Dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +, - 2% Duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 , Ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetëm 4 pozicione dhe është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar andaj edhe konstaton se AK-së me rastin e Ri-vlerësimit gabimisht i ka kalkuluar çmimet e OE Malësia,Tabela e kalkulimeveqë gjendet në shkresat e lendes është e nënshkruarnga anëtarete komisionit.

Kurse Ak-së-Komisioni i vlerësimit i ka ndryshuar **çmimet për njësi** duke ia përshtatur totalit të ofertës dhe AK-së gabimisht pretendon se ka gabime vetëm në TVSH. dhe për të njëjtat nuk vlen rregulla +- 2% ,sikur të ishte gabimi vetëm në TVSH .do ishte në rregull dhe te njëjtat nuk do kishin paraqitur problem sepse është e qartë dhe për të njëjtin çështje jo vetëm se ka jep interpretim KRPP-ja por ajo çështje është e gjykuar sepse ka vendim nga OSHP-ja që gabimet në TVSH i ka trajtuar si gabime që nuk hyjnë te rregulli +-2%, .

Mirëpo rasti i juaj hyn te gabimet në kalkulim sepse e tejkalojnë normën e lejuar dhe ju si AK-së nuk keni të drejt ti ndryshoni çmimet për njësi siç keni vepruar shih se si i keni ndryshuar çmimet për njësi po i shkruaj vetëm 4 pozicionet e para kurse ju i keni ndryshuar te gjitha njësit:

Pozicioni 1 çmimi për njësi në vend të çmimit 1.79 ju e keni ndryshuar në çmim 1.53

Pozicioni 2 çmimi për njësi në vend të çmimit 0.90 ju e keni ndryshuar në çmim 0.76
Pozicioni 3 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e keni ndryshuar në çmim 6.78
Pozicioni 4 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e keni ndryshuar në çmim 6.78

Kështu keni vepruar në të gjitha njësit dhe gabimisht e keni ndryshuar tërë ofertën .

Kjo mënyrë e vlerësimit bie në kundërshtim me paragrafin 41.10 pika b të nenit 41 të RRUOPP. Ekzaminimi,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve,ku ekskluzivisht e rregullon ketë çështje te njëjtin normë po e citoj si :

„Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet .Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmim për njësi ,tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr''
Andaj mbi këtë bazë Ekspertja shqyrtuese konstaton se pretendimi është i bazuar.

OE ankues"Er-Lis"shpk.&" N.N.T Eingcom "-Pejë,pretendon se Kuvendi Komunal Vushtrri nuk e ka respektuar Neni 67 të LPP-së Provat shkresore .

OE .ankues pretendon se dokumentacioni i ofruar është në kundërshtim me qëllimin e këtij neni i cili ka për qellim qe deklaratat dhe dokumentacioni i ofruar duhet të jetë nën betim dhe çdoherë ofertuesi mban përgjegjësi si nga aspekti penal dhe civil.

Sa i përket këtij pretendimi ekspertja sqaron se nuk është nënë kompetencat e mia sepse për këto pretendim janë organet tjera kompetente,kurse unë kam kompetencë vetëm të sqaroj se a ekziston apo jo dokumenti meqë ekzistenca e dokumentit nuk është kontestuese.
Ekspertja shqyrtuese konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues"Er-Lis"shpk.&" N.N.T Eingcom "-Pejë,pretendon se Kuvendi Komunal Vushtrri nuk e ka respektuar Neni 105 të LPP-së Kompetencat e OSHP-së par.2.10-2.12-dhe 2.16 të LPP-së
AK-së pas pranimit të vendimit OSHP-së me nr .126/19 të dt. 02.05.2019 gjegjësisht të Panelit Shqyrtues, konform par.1 të nenit 59 të LPP-së ka themeluar komision për Rivlerësimin ekzaminim dhe krahasimin e ofertave dhe i njëjtisiç parashihet me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së
Andaj, Ekspertja shqyrtuese konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .
Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura,ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e lartpërmendur të operatorit ekonomik ankues ta aprovoj si të BAZUAR (për arsyen që u cekën ma lart),dhe rekomandon që lënda të kthehet në Ri-vlerësim .

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues senuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues,përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi iOE-së z. Morina deklaroj:Qëndrojmë ne tërësi pran pretendimeve ankimore, Pajtohemi pjesërisht me mendimin e ekspertes shqyrtuese përveç faktin se ekspertes shqyrtuese nuk e ka potencuar se OE nuk i ka plotësuar listën e çmimeve te standardizuar ashtu siç është sqaruar ne DT, OE ka ndërhyrë ne këtë liste dhe nuk është përmbajtur bazës se DT. Tek Deklarata nen betim OE ka jepe disa listën e punëtorëve poashtu ka futur një punëtore qe nuk është i stafit te tije, i njëjti është punëtor ne KK-GJAKOVE si staf i përhershëm Inxhinier i Komunikacionit z. Pjeter Marku

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Islami deklarojë:Ne nuk pajtohemi me ekspertizën e ekspertes shqyrtuese, Në përgjigjen 1 dhe 2 ku ne përgjigjen 1 thotë pjesërisht e bazuar ku Autoriteti Kontraktues e ka trajtuar si të përgjegjshëm ndërsa me vonë këtë e shef ne përgjigjën nr 2 qe ka të bëjë me listën e përshkrimit te çmimeve. Ne si Autoritet Kontraktues dhe komisioni i rivlerësimit e kanë konsideruar si të përgjegjshëm poashtu edhe nga aspekti i analizës financiare është trajtuar i përgjegjshëm OE "Malesia" sepse gabimi i tij ka qenë vetëm ne përshkrimin e normës se TVSH-së dhe kjo është e korrigjueshme. Një aspekt tjetër qe kemi vërejtur është ekspertja shqyrtuese ka futur një dokument ne vlerësim qe nuk është ne DT. Është një liste jo e standardizuar te cilën ne si Autoritet Kontraktues e kemi përgatitur këtë mund ta prezantoj panelit shqyrtues, ekspertja shqyrtuese ne ekspertizën e saj ka marr listën e standardizuar sipas listës OE kanë mundësi te shkruajnë çmimin pa TVSH dhe normën e TVSH-së dhe kjo jepe çmimin për njësi për TVSH ku arrihet oferta e përgjithshme e një OE. Lista e çmimeve jo e standardizuar e ngritur nga Autoriteti Kontraktues e lejon OE qe te shënoj vetëm çmimin për TVSH dhe normën e TVSH-së. Te gjitha fushat tjera janë te koduara. Nisja e kalkulimeve është pikërisht me çmimet

me TVSH dhe ne konsiderojmë se çmimi për njësi i shkruar nga OE duhet të jetë i pandryshuar sipas LPP-së. Prandaj nuk pajtohemi me atë se potencon ekspertja shqyrtuese qe vlerësimi i çmimeve për njësi sikur se shihet edhe ne dokumentet e kalkulimit të bere nga komisioni i vlerësimit ku ata e kanë përshkruar vetëm çmimin me TVSH sipas OE "Malesia" dhe kanë bere korrigjimin e normës se TVSH, konsiderojmë se ne si Autoriteti Kontraktues kemi vepruar drejt ne aspektin e analizës financiare duke e ruajtur çmimin për njësi te shkruar nga OE te pa ndryshuar dhe duke bere vetëm korrigjimin e TVSH-së ashtu siç e lejojnë rregullat, prandaj kemi konstatuar qe nuk ka ndryshim ne vlerën e ofertës te lexuar ne rastin e hapjes te ofertës se OE dhe kjo nuk trajtohet korrigjimi i TVSH-së si gabim aritmetikor e cila nuk bie ne korrigjimin + - 2% vlerësimi ynë është ne përputhje me ligjet e LPP-së. Sa i përket deklaratave nen betim nuk mundemi me kuptuar deri ne fund, por deklarata qëndron, sa i përket punëtorëve konsiderojmë qe është e drejt e OE te angazhoje me kontrate ne vepër apo me pune dytësore. Sqarimet për tabelat do ti dërgojmë me e-mail panelit shqyrtues me datën 05.07.2019.

Gjatë prezantimit në seance Ekspertja shqyrtues znj. Krasniqideklarojë: Ne lidhje me deklaratën OE ka me tepër inxhinier se sa kanë kërkuar ne DT i plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues, sa i përket tabelave i kam sqaruar ne ekspertize. Qëndroj prapa raportin tim te dhënë në ekspertizë me datë 21.06.2019.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë te aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe kërkojmë qe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Propozojmë të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional , deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e OE "Er-Lis"SH.P.K. & N.N.T."EingCom"- Pejë –se Kuvendi Komunal i Vushtrri nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së,ky nen është shkelur pasi që AK-ja, nuk i ka vlerësuar të gjithë OE njësoj, sipas OE ankues.
Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se Qëllimi i nenit 7 të LPP-së është që AK. ti trajtojë Operatoret ekonomik në mënyrë të barabartë,pa diskriminim dhe në mënyrë transparente. AK-së gjatë Ri-vlerësimit Operatorin Ekonomik ankues, e ka trajtuar si OE. të

pasuksesshëm ngase nuk ishte tenderi me çmim më të lirë ,duke sqaruar se ishte ofertë që i plotëson të gjitha kriteret e parapara me NJ.K. dhe dosjen e tenderit.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK e ka trajtuar OE "Malësia" si OE i përgjegjshëm dhe e ka rekomandua për shpërblim me kontratë dhe se njëjti nuk është i përgjegjshëm sipas OE ankues. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se pretendimi i OE ankues qëndron dhe i njëjti është i pjesërisht i bazuar .

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Er-Lis"SH.P.K. & N.N.T."EingCom"- Pejë, se Kuvendi Komunal i Vushtrri nuk ka respektuar nenin 24.10 dhe neni 26.8 te Rregullat e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se Qëllimi i nenit 24.10 është të rregullohet mënyra e Listës së çmimeve që gjenerohet në sistem dhe rregullat se si duhet të plotësohet dhe neni 26.8 ka për qellim të sqaroj lidhur me kriteret e përzgjedhjes që mund të përdorën nga AK-së e te cilat janë të vendosura në NJ.K. dhe në D.T.

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues sqaron se sipas nenit 24 paragrafi 10 te AK ka ngarkuar : Lista e çmimeve e standardizuar është një Liste e çmimeve që gjenerohet nga sistemi dhe përmban elemente të paracaktuara të Listës se çmimeve. Kjo Liste e çmimeve shkarkohet nga faqja e internetit të Prokurimit Publik Elektronik në Kosovë. Lista e çmimeve e standardizuar gjenerohet në formë të standardizuar të Excel-it ose kjo liste mund te plotësohet direkt në formën e sistemit ose, ne rast se kjo e liste e standardizuar nuk i plotëson nevojat (specifikat e ndryshme) e AK, AK mund të krijoj një liste te re. Pas plotësimit dhe ngarkimit, Lista e çmimeve e standardizuar shndërrohet në një format të Listës se çmimeve e cila është e përshtatshme për tenderuesit, me fusha të mbyllura të përcaktuara nga autoriteti kontraktues dhe me fushat e shënuara për tu plotësuar nga ofertuesit:

1. Çmim për njësi 2. Norma e TVSH-së 3. Emri i prodhuesit 4. Shënimi i Ofertuesit, sipas OE ankues

Ekspertja shqyrtuese konstaton, se Dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +, - 2% duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ,

Ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetëm 4 pozicione si me ekspertizën paraprake dhe është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar andaj edhe konstaton se AK. me rastin e Ri-vlerësimit

gabimisht i ka ndryshuar çmimet për njësi prapë po i përmendi vetëm 4 pozicionet e para ku OE .ka ofertuar me këto çmime për njësi si në tabelë :

Operatori Ekonomik :Malsia NPTGN.

Nr. Përshkrimi I pozicioneve Njësia Sasia Çmimi për njësi € (pa tvsh) TVSH (%) Çmimi njësi me TVSH € Çmimi total me TVSH € (I llogaritur nga Ekspertja e Prokurimit) Çmimi total me TVSH € (I dhënë nga OE) dhe Komisioni I Rivlerësimit Ndryshimi I totalit të çmimit

1 A1- Vijë e plotë e pandërprerë b=120mm m 3800 1.79 0.32 2.11 8,026.36 6,840.00 1,186.36

2 A2 vijë e ndërprerë b=120mm(e mesit) m 7200 0.90 0.16 1.06 7,646.40 6,480.00 1,166.40

3 A3 Vendkalim të këmbësoreve (me para-vijëzim) m 580 7.89 1.42 9.31 5,399.92 4,640.00 759.92

4 A4 -Shenja tërthore në rrugë (vijë e ndalimit) me gjerësi 500mm m 72 7.89 1.42 9.31 670.33 156.00 514.33

Totali i Përgjithshëm 21,743.01 18,116.00 3,627.01

Totali I përgjithshëm I dhëne nga OE 18,116.00

Dallimi ne kalkulim OE-Komisioni I Ri vlerësimit(vetëm për 4 pozicione) (3,627.01)

Norma e lejuar e gabimit aritmetik (për 4 pozicione) 2%

362.32

Konstatim: Dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +, - 2% Duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 , paneli shqyrtues sqaron se Ekspertja shqyrtuese profesionale ka kalkuluar vetëm 4 pozicione dhe është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar andaj edhe konstaton se AK-së me rastin e Ri-vlerësimit gabimisht i ka kalkuluar çmimet e OE Malësia, Tabela e kalkulimeve që gjendet në shkresat e lendes është e nënshkruar nga anëtaret e komisionit.

Kurse AK-së-Komisioni i vlerësimit i ka ndryshuar çmimet për njësi duke ia përshtatur totalit të ofertës dhe AK-së gabimisht pretendon se ka gabime vetëm në TVSH dhe për të njëjtat nuk vlen rregulla +- 2% ,sikur të ishte gabimi vetëm në TVSH .do ishte në rregull dhe te njëjtat nuk do kishin paraqitur problem sepse është e qartë dhe për të njëjtin çështje jo vetëm se ka jep interpretim KRPP-ja por ajo çështje është e gjykuar sepse ka vendim nga OSHP-ja që gabimet në TVSH i ka trajtuar si gabime që nuk hyjnë te rregulli +- 2%.

Mirëpo rasti i juaj hyn te gabimet në kalkulim sepse e tejkalojnë normën e lejuar dhe ju si AK-së nuk keni të drejt ti ndryshoni çmimet për njësi siç keni vepruar shih se si i keni ndryshuar çmimet për njësi po i shkruaj vetëm 4 pozicionet e para kurse ju i keni ndryshuar te gjitha njësit:

Pozicioni 1 çmimi për njësi në vend të çmimit 1.79 ju e keni ndryshuar në çmim 1.53
Pozicioni 2 çmimi për njësi në vend të çmimit 0.90 ju e keni ndryshuar në çmim 0.76
Pozicioni 3 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e keni ndryshuar në çmim 6.78
Pozicioni 4 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e keni ndryshuar në çmim 6.78

Kështu keni vepruar në të gjitha njësit dhe gabimisht e keni ndryshuar tërë ofertën .

Paneli shqyrtues konform ekspertimi shqyrtues profesional konstaton se kjo mënyrë e vlerësimit bie në kundërshtim me paragrafin 41.10 pika b të nenit 41 të RRUOPP. Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, ku ekskluzivisht e rregullon ketë çështje te njëjtin normë po e citoj si :

„Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet .Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmim për njësi ,tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr''
Andaj mbi këtë bazë konstatojm se pretendimi është i bazuar .

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Er-Lis"shpk.&" N.N.T Eingcom "-Pejë, se Kuvendi Komunal Vushtrri nuk e ka respektuar Neni 67 të LPP-së Provat shkresore .
OE ankues pretendon se dokumentacioni i ofruar është në kundërshtim me qëllimin e këtij neni i cili ka për qellim qe deklaratat dhe dokumentacioni i ofruar duhet të jetë nën betim dhe çdoherë ofertuesi mban përgjegjësi si nga aspekti penal dhe civil.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se nuk është nënë kompetencat e ekspertit shqyrtues pretendimi i lart cekur sepse për këto pretendim janë organet tjera kompetente, kurse eksperti dhe paneli shqyrtues ka ne kompetencë vetëm të sqaroj se a ekziston apo jo dokumenti meqë ekzistenca e dokumentit nuk është kontestuese.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Er-Lis"shpk.&" N.N.T Eingcom "-Pejë, se Kuvendi Komunal Vushtrri nuk e ka respektuar Neni 105 të LPP-së Kompetencat e OSHP-së par. 2.10-2.12-dhe 2.16 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se AK- pas pranimit të vendimit OSHP-së me nr .126/19 të dt. 02.05.2019 gjegjësisht të Panelit Shqyrtues, konform par.1 të nenit 59 të LPP-së ka themeluar komision për Rivlerësimin ekzaminim dhe krahasimin e ofertave dhe i njëjti siç parashihet me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, andaj, konstatojmë se ky pretendim është i pa bazuar .

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Komuna Vushtrri,–Vushtrri,

1x1 OE–"Er-Lis"SH.P.K. & N.N.T."EingCom"- Pejë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.